

Politikat Sociale

në Programet e Partive Politike: **A ka rëndësi barazia?**

The views expressed in this publication are not necessarily those of the Friedrich Ebert Foundation or of the organizations for which the authors work.

The publication is available online at www.fes-prishtina.org

PASQYRË E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE	5
1/ SFONDI	8
1.1 Sfondi i hulumtimit	8
1.2 Pasqyrë e politikave sociale dhe partive politike	10
2/ GJETJET	12
2.1 Pasqyrë e përgjithshme e praktikave	12
2.1.1 Shpeshhtësia e përmendjes së politikave/kategorive sociale-	13
2.1.2 Politikat dhe masat e propozuara për çështjet dhe kategoritë sociale	16
2.2 Programi zgjedhor 2017	17
2.2.1 Koalicioni LDK-AKR-Alternativa (LAA)	17
2.2.2 Lëvizja Vetëvendosje! (LVV)	19
2.2.3 Koalicioni PDK-AAK-Nisma (PAN)	21
3/ PËRFUNDIMET	24
BIBLIOGRAFIA	27
SHTOJCA 1. Indeksi i shprehjeve të politikave sociale të përdorura nga partitë politike	30

PASQYRA E TABELAVE

Tabela 1. Numri i përmendjeve të të moshuarve	13
Tabela 2. Numri i përmendjeve të grave	14
Tabela 3. Numri i përmendjeve të fëmijëve	15
Tabela 4. Numri i përmendjeve të personave me nevoja të veçanta	15
Tabela 5. Numri i përmendjeve të të varfërve	15
Tabela 6. Numri i përmendjeve të të papunëve	16

PËRMBLEDHJE

Në mënyrë që të përshkruajë shpërfilljen njëdekadëshe të partive politike kundrejt çështjeve sociale dhe grupeve të marginalizuara në përgjithësi, IKS nxjerr këtë analizë që fokusohet si në hapësirën që partitë/koalicionet politike ua japin çështjeve sociale në programet e tyre, ashtu edhe në cilësinë e ofertave të bëra. Shteti më i ri në Europë ofron pak mbrojtje sociale për popullsinë e vet dhe nuk arrin t'i adresojë madje as nevojat themelore të grupeve të marginalizuara. Derisa miliarda euro shpenzohen për projekte infrastrukturore, shumë pak vullnet tregohet për përmirësimin e sistemit të sigurisë sociale nga cilado prej partive kryesore të spektrit politik.

Programet politike të tri subjekteve udhëheqëse gjatë zgjedhjeve të kaluara nacionale – PAN-i, LVV-ja dhe LAA-ja – analizohen në këtë raport nëpërmjet një vështrimi kritik, duke mundësuar kështu dallimin ndërmjet fakteve dhe iluzioneve brenda premtimeve të partive politike. Kujtesa institucionale e ekipit të IKS-it mundëson evidentimin e lehtë të praktikave të kaluara, të cilat gjithashtu merren në konsideratë kur vlerësohet qëndrueshmëria e zgjedhjeve të propozuara. Përmes një game instrumentesh dhe metodash kualitative, intervista me përfaqësues kyçë të secilës prej

partive politike të përfshira gjithashtu janë sistemuar, për të mbuluar aspekte/fusha të cilat nuk janë paraqitur në programet e tyre të shkruara.

Si analiza sasiore (për sa i përket numrit të përmendjeve të kategorive/grupeve sociale) ashtu edhe analiza cilësore e këtyre referencave/zotimeve të tri blloqeve më të mëdha politike në zgjedhjet nacionale të vitit 2017 zbulojnë se partitë u japin prioritet të vogël politikave sociale. Asnjëra prej tyre nuk arrin të ofrojë program gjithëpërfshirës social i cili synon t'u përgjigjet nevojave të popullsisë së cilës ai program i kushtohet. Në pika të trasha, hulumtimi tregon se nuk mund të priten ndryshime të mëdha nga qasjet politike aktuale për sa u përket politikave sociale më gjithëpërfshirëse, dhe mbrojtjes më të madhe të grupeve të cënueshme. Zotimet politike të të gjitha partive politike/koalicioneve të monitoruara gjatë periudhës zgjedhore, në të shumtën e rasteve nuk konceptualizohen mirë, ofrojnë shumë pak inovacion, dhe/ose nuk janë të zbatueshme në të ardhmen e afërt në Kosovë.

Koalicioni PAN për më pak se 200 ditë të qeverisjes ka kundërshtuar efektivisht rritjen e pagës minimale të propozuar nga Këshilli Ekonomik Social, ka votuar kundër amendamentit i cili u mundëson

qasje të barabartë fëmijëve me nevoja të veçanta, derisa vetes i ka siguruar rritje të paligjshme të pagës. Për më tepër, kjo qeverisje me papërgjegjësi të plotë u ka falur rreth 60 milionë euro borxh kompanive private të cilat u detyroheshin kompanive publike, si dhe ka paguar një çmim të fryrë të ridakordimit për fushën e re të nxjerrjes së qymyrit. Koalicioni PAN (dhe anëtarët e tij) kanë qenë pjesë e të gjitha koalicioneve qeverisëse që nga krijimi i institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse në kuadër të UNMIK–ut, derisa PDK–ja si partia kryesore e këtij koalicioni ka qenë pjesë e secilës qeveri që nga shpallja e pavarësisë më 2008. Premtimet zgjedhore të paraqitura nga Koalicioni PAN nuk mund të merren seriozisht nëse merret për bazë performanca e tyre në të kaluarën, ndërkohë që programi i tyre zgjedhor nuk mund të gjendet në internet ose në ndonjë formë tjetër të qasshme për publikun. Kalimi nga pakënaqësia totale në gjendjen e cila projektohet përmes premtimeve të tyre zgjedhore ka gjasa të vogla që të ndodhë. Kostoja e disa prej premtimeve të dhëna e tejkalon shumëfish potencialin buxhetor të Kosovës. Duke marrë parasysh se anëtarët e saj mbajnë peshën më të madhe të fajit për mungesën e vëmendjes ndaj politikave sociale deri më sot, nuk

priten shumë ndryshime prej tyre edhe në të ardhmen.

Koalicioni LAA, që përfaqëson disa prej pozicioneve më konservatore dhe neoliberales, qoftë në aspektin e kohës, qoftë në aspektin e vëmendjes apo në aspektin e cilësisë së zgjidhjeve të ofruara, nuk përfaqëson alternativë më të mirë se koalicioni PAN. Qasja në programin e LAA ishte e kufizuar, duke pasur parasysh mos disponueshmërinë e tij në internet dhe shpërndarjen e broshurave vetëm tek një numër i kufizuar i njerëzve. Edhe ky koalicion në të kaluarën ka treguar se ka prirje të tkurrë mbulueshmërinë e rreziqeve sociale në vend se ta përmirësojë atë. Programi zgjedhor pasqyron pak apo fare përmirësim krahas performancës së kaluar, pasi që LDK ka menaxhuar mirëqenien sociale në koalicionin e mëparshëm qeverisës. Qasja konservatore ndaj skemave sociale pritet nga LDK–ja edhe në të ardhmen, në rast se i qëndron besnike diskursit aktual.

LVV, si e vetmja parti e majtë e përcaktuar qartë dhe e vetmja parti me qasje publike në programin e saj elektorale, tregon pak vëmendje në kategoritë që supozohet se duhet t'i përfaqësojë. Si alternativë tjetër në spektër, LVV–ja nuk arrin t'i mbulojë nënsegmentet specifike brenda popullsisë së cënueshme, dhe rrjedhimisht as nuk ia del t'i adresojë

efektivisht nevojat e tyre. Në vend të propozimit të zgjidhjeve konkrete për shqetësimet specifike të secilës prej kategorive të cënueshme, LVV-ja prezenton reformën e përgjithshme sistemore për të cilën, në rastin më të mirë, do të duheshin dekada për të pasur efekt real, në rast se kjo në rend të parë do të ishte e mundur/e jetësueshme. Për më tepër, masat e propozuara bartin në vete barrë të madhe financiare dhe nuk mund të mbështeten nga buxheti aktual i Kosovës, duke e bërë zgjidhjen e LVV-së dhe ofertën e saj pragmatike, të duket joreale dhe populiste. Një shpërfillje e tillë nga ana e

partive politike si dhe mungesa e kërkesave koherente që vinë nga grupet e cënueshme i bën mediat dhe shoqërinë civile alternativa të vetme potenciale për të avokuar për drejtësi dhe mirëqenie më të madhe sociale. Organizatat e shoqërisë civile dhe mediat duhet të krijojnë një front të bashkuar për t'a shtyrë përpara agjendën sociale, si dhe për t'i futur politikatat sociale në agjendën politike dhe legjislativë. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi i votuesve është gjithashtu shumë i nevojshëm për të prodhuar llogaridhënie dhe përgjigje të partive politikeme politika sociale më gjithëpërfshirëse.

1.1 Sfondi i hulumtimit

Përkundër miliona eurove që po shpenzohen për politika sociale çdo vit, varfëria mbetet njëra prej sfidave më të mëdha të Kosovës. Të dhënat e Bankës Botërore për Kosovën tregojnë se rreth 29% e banorëve jetojnë në pragun e varfërisë me më pak se 1.72 euro në ditë. Segmentet më të prekura të shoqërisë në aspektin financiar përfshijnë personat me nevoja të veçanta, komunitetet e cënuara financiarisht (sidmos romët), të moshuarit, dhe gratë. Votuesit nuk ia kanë dalur të kërkojnë mirëqenie më të madhe, dhe rrjedhimisht edhe partitë politike nuk kanë ofruar zgjidhje për sfidat e tyre. Shteti i mirëqenies në Kosovë nuk ekziston dhe segmentet më të ndieshme të shoqërisë janë të pambrojtura. Sistemi shëndetësor publik, sidomos shërbimi shëndetësor terciar, është në prag të kolapsit. Beneficioni i vetëm të cilin e gëzojnë të moshuarit vjen në formën e pensionit bazë të pleqërisë, i cili nuk mjafton për të mbuluar nevojat themelore personale.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është t'i edukojë partitë politike dhe opinionin e përgjithshëm për rëndësinë e politikave sociale. Fokusi në programet e partive politike kërkon të prodhojë rezultate të dyfishta. Në njërën anë, ai ka për qëllim të nxisë reagimin e partive

politike duke përgatitur oferta më gjithëpërfshirëse të politikave sociale, por edhe duke e motivuar opinionin e përgjithshëm të kërkojë llogaridhënie nga partitë politike dhe mbrojtje më të madhe sociale. Hulumtimi, pjesë e këtij raporti, u realizua duke aplikuar një gamë metodash cilësore dhe sasore siç është:

1. Hulumtimi i materialeve ekzistuese.

- a. ➤ Analiza komparative e programeve të shkruara të partive politike. Kjo metodë ka shërbyer për të bërë dallimin ndërmjet programeve të partive politike në Kosovë. Shqyrtimi teorik i temave të mbuluara duke përfshirë edhe shqyrtimin e burimeve të ndryshme akademike gjithashtu u realizua si pjesë e hulumtimit të materialeve ekzistuese. Shqyrtimi i raporteve relevante dhe i analizave paraprake, si dhe shqyrtimi i infrastrukturës ligjore dhe të asaj institucionale ishte pjesë e aktiviteteve të hulumtimit të materialeve ekzistuese.
- b. ➤ Sjelljet e partive politike dhe gjurmimi i vendimeve politike në Kuvend dhe në Qeveri (testimi i konsistencës së platformës, konsistencës ideologjike, etj.) ka qenë aspekti i dytë i hulumtimit të materialeve ekzistuese. Shqyrtimi i

koncept-dokumenteve, raporteve të mediave, dhe të burimeve të tjera online janë përdorur për të krahasuar platformat e partive politike me sjelljet e tyre në praktikë.

2. Intervistat

Nga dy zyrtarë të lartëprej secilës parti politike janë intervistuar për të mbledhur të dhëna për politikën sociale të cilat janë promovuar/zbatuar nga viti 2008, si dhe për të mbledhur informacione për politikën të planifikuar në të ardhmen.

Përveç shënjestrimit të partive politike, hulumtimi gjithashtu synon ta rrisë ndërgjegjësimin e opinionit publik/votuesve si dhe ta ngrisë transparencën e partive politike dhe të programeve të tyre. Analiza programore dhe e diskursit e paraqitur në këtë raport ofron pasqyrë të të menduarit dhe të praktikave të partive më të mëdha politike në Kosovë. Ajo i zberthen qëndrimet e tyre të proklamuar, diskursin dhe pozicionet e tyre ndaj çështjeve sociale. Analizën e ka përgatitur IKS-i, si pjesë e kontributit të vet në punën e Koalicionit për Drejtësi Sociale, i cili përfaqëson frontin e përbashkët të shoqërisë civile për përmirësimin e

drejtësisë sociale në Kosovë. Hulumtimi i cili është subjekt i këtij raporti shtjellon praktikën e fundit të partive politike dhe sjelljet e tyre të vëzhguara gjatë zgjedhjeve të fundit nacionale dhe lokale, dhe i përdor këto informacione për t'i pozicionuar qëndrimet dhe vlerat e partive politike kundrejt çështjeve dhe politikave sociale. Përveç shpeshësisë së përdorimit dhe të përmendjes së çështjeve sociale nga ana e politikanëve, është analizuar edhe konteksti në të cilin ato janë përdorur, si dhe diskursi i propozuar për t'i zgjidhur këto çështje. Si i tillë, raporti ofron një analizë unike e cila vë në pah hierarkinë e prioritetëve të partive politike, si dhe zgjidhjet e tyre të propozuara për problemet e identifikuar/të përmendura gjatë fushatës. Ai ka për qëllim të paraqesë një analizë objektive të çështjeve prioritare të ngritura nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore si dhe të zgjidhjeve të propozuara nga partitë politike (kur kishte raste të tilla).

1.2 Pasqyrë e politikave sociale dhe partive politike

Njëra prej arsyeve parësore për nisjen e këtij hulumtimi, pjesë e këtij raporti, ishte mungesa e gatishmërisë së partive politike t'i përgjigjen presionit social i cili sa vinte e rritej. Partitë politike në Kosovë që nga marrja e kompetencave nga UNMIK-u nuk kanë treguar shumë interesim ta shtyjnë përpara mbrojtjen, shërbimet apo mirëqenien sociale. Përkundër faktit se ajo ishte njëra prej kompetencave të para e cila u transferua në duar të vendimmarrësve vendorë, sistemi i mirëqenies sociale në Kosovë është ndër më të pazhvilluarit në Europë. Mbrojtja sociale në Kosovë përfshin një numër të vogël shërbimesh sociale dhe beneficioneve me të holla. Niveli i ulët i pjesëmarrjes aktive në tregun e punës e ka vështirësuar shumë avansimin e mbulueshmërisë universale karshi rreziqeve sociale dhe ekonomike që rëndom mbulohen në shtetet e tjera. Edhe pse synon të adresojë rreziqet sociale të njërit prej vendeve më të varfëra në Europë, sistemi i mbrojtjes sociale në Kosovë bazohet në parimet neoliberale të ndërhyrjeve të kufizuara të shtetit dhe të mbrojtjes së paktë për më të pafatit e shoqërisë.

Kosova është vendi i vetëm në Europë i cili nuk ka sistem të sigurimit shëndetësor publik. Kosova

gjithashtu nuk ka beneficione për të papunët; në vend të kësaj, Qeveria ka marrë mbështetjen e shumë donatorëve për tësajuar Masa të Tregut Aktiv të Punës, që synojnë ta harmonizojnë kërkesën dhe ofertën ndërmjet punëdhënësve dhe punëkërkuësve. Si të tilla, instrumentet e Tregut Aktiv të Punës shihen si masa komplementare për të siguruar jetë më të mirë të qytetarëve përmes rritjes së punësimit dhe të të ardhurave nga puna, në vend të beneficioneve me të holla që i jep shteti. Moshë e shtyrë është edhe një rrezik i cili mbulohet nga skemat pensionale të financuara nga shteti, përmes Skemës Pensionale të Moshës, e cila është shtylla e parë e sistemit pensional në Kosovë. Edhe përkritazi me këtë rrezik ka pasur përpjekje për ta zvogëluar mbulueshmërinë e tij, si dhe për ta hequr mbulueshmërinë universale të parashikuar përmes Skemës së Pensionit Bazik.¹

Ndihma social është e vetmja skemë me të holla e cila adreson çënueshmërinë financiare të kosovarëve. Nidhma sociale u jepet familjeve dhe jo individëve, dhe ajo përfshin një listë të gjatë kriteresh të cilat një familje e caktuar duhet t'i plotësojë për të qenë e kualifikueshme për marrjen e ndihmës. Organizatat e shoqërisë

¹ Qeveria e kaluar formalisht e ka inicuar procesin për ndryshimin e Ligjit për skema pensionale të financuara nga shteti, por procesi ka ngecur për shkak të presionit të shoqërisë civile dhe të BE-së.

civile i kanë kundërshtuar kriteret e përdorura për përcaktimin e kualifikueshmërisë për të marrë beneficione nga skema e ndihmës sociale dhe ato i kanë konsideruar diskriminuese (p.sh. që familja të ketë një fëmijë nën moshën 5-vjeçare² apo një të moshuar mbi moshën 65-vjeçare)

Diskriminimi ndaj individëve dhe grupeve gjithashtu është raportuar nga OSHC-të dhe mediat, sidomos përkitazi me moshën, racën, dhe gjininë. Mbrojtja kundër diskriminimit e përcaktuar si në nivel të Kushtetutës, ashtu edhe në nivel ligjesh, ndalon qartë çfarëdo forme të diskriminimit dhe parasheh masa për luftimin e tij. Megjithatë, diskriminimi i tillë është shumë i pranishëm në Kosovë. Diskriminimi gjinor më së shpeshti haset te konkurset për punë (p.sh., specifikimi i gjinisë për një konkurs të punës), dhe/ose shkëputja e kontratës me gratë shtatzëna. Diskriminimi në aspektin e moshës gjithashtu haset shpesh në Kosovë. Diskriminimi racor gjithashtu raportohet shpesh. Më të diskriminuarit në baza racore janë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, të cilat gjithashtu janë ndër komunitetet etnike më të papunësuar në Kosovë.

Zgjedhjet e vitit 2017 në Kosovë si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror u konsideruan të drejta dhe

demokratike, përkundër faktit që ishin gati përjashtimisht zgjedhje mashkullore. Përderisa teknikisht ato i plotësuan kriteret dhe standardet, në praktikë kandidateve në këto zgjedhje iu dha pak apo nuk iu dha fare hapësirë t'i prezentonin vet idetë e tyre. Kandidateve iu dha shumë pak hapësirë gjatë fushatës, dhe vetëm një numri të vogël të grave brenda secilit koalicion iu ofrua hapësirë në ngjarjet më të mëdha zgjedhore. Si rrjedhojë, kabineti i tanishëm qeveritar i cili përbëhet nga më se 100 ministra dhe zëvendësministra, në radhët e veta ka më pak se 5% gra. Koalicionet e mëdha në zgjedhjet e parakohshme nacionale prodhuan efekte të pafavorshme për gratë në garat zgjedhore. Proceset zgjedhore, rrjedhimisht, mund të konsiderohen gjysmëdemokratike, duke pasqyruar kështu zbatimin e standardeve dhe të praktikave demokratike vetëm për gjysmën e popullsisë (burrat), por jo edhe për gjysmën tjetër (gratë).

¹ Qeveria e kaluar formalisht e ka inicuar procesin për ndryshimin e Ligjit për skema pensionale të financuara nga shteti, por procesi ka ngecur për shkak të presionit të shoqërisë civile dhe të BE-së.

² Kriteri i cili aplikohet është që familja ta ketë një fëmijë nën moshën 5-vjeçare, dhe kjo shpeshherë është thënë të jetë ndër arsyet primare për numrin e madh të fëmijëve në familjet që marrin ndihma sociale.

2.1 Pasqyrë e përgjithshme e praktikave

Shumica e partive politike dhe e politikanëve në Kosovë rrallëherë i përmendin çështjet sociale dhe rrallëherë kërkojnë/proponojnë zgjidhje për to. Të gjitha partitë politike e kanë parë punësimin dhe zhvillimin ekonomik si zgjidhjen e vetme për përmirësimin e mirëqenies së kosovarëve. Si rrjedhojë, ka shumë pak diskutime për politikën sociale dhe ato zakonisht shihen si të rëndësishme dytësore kundrejt temave "të mëdha politike", në të cilat partitë angazhohen plot gatishmëri. "Çështjet e mëdha"³ të cilave u kushtohet vëmendje e madhe emocionale dhe patriotike kanë qenë shkak për zgjedhjet e parakohshme nacionale në vitin 2017. Ndjeshmëria e këtyre temave dhe rëndësia e cila u jepet nga mediat, e kanë lënë në hije çdo nismë dhe/ose proces tjetër.

Edhe atëherë kur çështjet sociale arrijnë majën e agjendës dhe diskutohen qoftë në media, qoftë nga politikanët, pjesa më e madhe e energjisë shpenzohet për problemet e jo për propozimin e zgjidhjeve për to. Qeveritë rëndom i fajësojnë paraardhësit e tyre për gjendjen në sistemin e mbrojtjes sociale, por bëjnë pak përpjekje për ta zhvilluar më tej sistemin kur atyre u jepet një mundësi e tillë. Vendimi i fundit i koalicionit aktual qeverisës për t'i rritur pagat e zyrtarëve të lartë të kabinetit qeveritar, por jo edhe

pagën minimale prej 170 në 250 euro në muaj, flet për mungesën e ndjeshmërisë së vendimmarrësve ndaj segmenteve më të cënueshme të popullsisë dhe pasqyron shpërfilljen e përgjithshme ndaj kohezionit social, e cila e ka përcjellë politikën kosovare që nga periudha e pasluftës.

Edhe kur analizohen praktikat e votimit të partive politike në Kuvend, më së shpeshti ato anojnë nga e djathta ideologjike. Shpeshherë partitë me orientim të proklamuar të qendrës së djathtë, gjithashtu shpesh votojnë në kundërshtim me orientimin e tyre ideologjik. Shumica e praktikave të votimit në Kuvend bëhen en-bloc, ku deputetët zakonisht i nënshtrohen rekomandimit/pozicionit të partisë ndaj çështjes në fjalë. E kjo zakonisht bazohet në prioritetet ditore të grupeve të vogla të vendimmarrësve, dhe zakonisht bazohet në llogaritjet aritmetike të probabilitetit të kalimit të ligjeve të caktuara. Pozicioni i tyre ka qenë më shumë pragmatik se ideologjik dhe shumë pak vendime/ligje/nisma i shmangen këtij rregulli të përgjithshëm. Një politikë sociale e cila së fundi dështoi të kalonte në Kuvendin e Kosovës gjithashtu flet për këtë shpërfillje totale të politikave sociale. Ajo ka të bëjë me fëmijët me nevoja të veçanta, dhe për shkak të një buxheti prej

³Siç është procesi i dialogut me Beogradin si dhe Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi.

700.000 eurove, ligji nuk kaloi duke u mohuar qindra fëmijëve me nevoja të veçanta arsim cilësor në shkolla publike. Shumica e reformave të politikave sociale të inicuar rishtazi më shumë kishin për synim ta zvogëlojnë barrën mbi buxhetin shtetëror sesa ta përmirësojnë cilësinë dhe/ose mbulueshmërisë e rreziqeve. Reforma pensionale e inicuar me qëllim të zvogëlimit të buxhetit për këtë skemë, duke i shpërfillur tërësisht mbi 80% të grave në Kosovë⁴, është edhe një shembull i një praktike të tillë. Ngjashëm me këtë, reforma e Ligjit të Punës me qëllim të zvogëlimit të mbulueshmërisë dhe beneficioneve të pushimit të lehonisë, gjithashtu flet për qasjen e politikëbërësve ndaj reformës së politikave sociale.

2.1.1. Shpeshtësia e përmendjes së politikave/kategorive sociale

Aspekti i parë i analizuar në këtë raport është shpeshtësia me të cilën partitë politike i përmendin/vënë në pah çështjet dhe konceptet sociale. Në dritë të kësaj, IKS-i ka monitoruar numrin e rasteve kur përmenden edhe temat edhe grupet e marginalizuara në programet e partive politike dhe në paraqitjet publike të përfaqësuesve të partive politike. Grupet e synuara të mbuluara me këtë monitorim përfshinë: të moshuarit, gratë,

fëmijët, personat me nevoja të veçanta, të varfërit, të papunët, dhe kategoritë sociale që kanë të bëjnë me luftën. Këto grupe shpeshherë gërshetohen duke shkaktuar edhe më shumë çënueshmëri të disa segmenteve të popullsisë, por përgjithësisht këto kategori përfaqësojnë pjesën më të madhe të popullsisë së Kosovës.⁵ Përkundër faktit se përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë në aspektin e shifrave, atyre u jepet shumë pak prioritet nga politikanët dhe partitë politike.

Për sa u takon të moshuarve, disa prej nocioneve të cilat i ka mbuluar monitorimi dhe analiza janë: njerëzit në moshë, mbi moshën 65-vjeçare; pensionistët; të moshuarit; përvoja e punës. Këto nocione përdoren më së shpeshti për ta përshkruar kategorinë e qytetarëve të moshuar si dhe politikën që u përshtaten nevojave të tyre. Në dritë të kësaj, koalicioni PAN ka qenë më i vëmendshëm për sa i përket kësaj audience të synuar, duke e përmendur kategorinë e të moshuarve gjithsej nëntë herë. E dyta me radhë sa i përket shpeshtësisë/numrit të përmendjeve të të moshuarve ka qenë LVV-ja me gjithsej tri përmendje, derisa koalicioni LAA zë vendin e fundit, me vetëm një përmendje të kësaj kategorie sociale.

⁴Pjesëmarrja e grave në tregun e punës është nën 20%, dhe prandaj hegja e mbulueshmërisë së pensionit bazik dhe futja e kriterëve në bazë të nevojave do t'i prekte drejtpërdrejt gratë e papunësuar të cilat aktualisht përfillojnë nga kjo skemë.

⁵P.sh. gratë përbëjnë 50% të popullsisë. Fëmijët përbëjnë rreth 20% të popullsisë. Personat mbi moshën 65-vjeçare përbëjnë rreth 5% të popullsisë. Mbi 20% të kosovarëve konsiderohen të varfër. Rreth 10% e popullsisë konsiderohen të jenë personat me nevoja të veçanta.

Tabela 1. Numri i përmendjeve të të moshuarve

#	Partia Politike/Koalicioni	Numri i përmendjeve
1	LDK, AKR and Alternativa (LAA)	1
2	Levizja Vetevendosje! (LVV)	3
3	PDK, AAK, and Nisma (PAN)	9

Kategoria e dytë e personave të përfshirë në analizë janë gratë. Nacionet specifike të analizuar dhe të monitoruara përfshijnë: nënat; vajzat; gratë; lehonja për gratë e punësuar; lehonja për gratë e papuna; nënat e vetme; dhuna në familje; dhe nënat e reja. Në dritë të kësaj, koalicioni PAN nuk i përmend fare nënat, derisa LVV-ja dhe LAA-ja i përmendin nënat nga një herë secila në ofertën e tyre zgjedhore. Vajzat e reja përmenden si kategori vetëm nga LVV-ja, derisa LAA-ja i përmend një herë të punësuarat. Të trija partitë i përmendin shpesh gratë në programet e tyre, konkretisht LVV-ja dhe LAA-ja nga tri herë secila, derisa PAN-i këtë kategori e përmend nëntë herë. LVV-ja nuk i përmend gratë në lehonja, LAA-ja një herë, derisa PDK-ja i përmend shtatë herë e LAA-ja gjithashtu i përmend njëherë të punësuarat në pushim të lehonisë. PAN-i dhe LDK-ja e përmendin dhunën në familje nga një herë secila, derisa LVV-ja nuk e mbulon

këtë temë. Nënat e vetme janë kategori tjetër e grave të cilën e ka mbuluar monitorimi dhe analiza. Sa i përket kësaj nënkategorie të grave, vetëm LVV-ja e përmend atë një herë, derisa LAA-ja dhe PAN-i nuk japin komente për këtë audiencë të synuar.

Tabela 2. Numri i përmendjeve të grave

#	Partia Politike/Koalicioni	Numri i përmendjeve ⁶
1	LDK, AKR and Alternativa (LAA)	8
2	Levizja Vetevendosje! (LVV)	9
3	PDK, AAK, and Nisma (PAN)	17

Kategoria e tretë në të cilën u fokusua monitorimi ishin fëmijët. Kjo kategori e cënueshme që shfaqet në shumë forma e variacione, lidhet me shumë çështje dhe përfshin shumë nëngrupe. Brenda kategorisë së fëmijëve, monitorimi i ka kushtuar vëmendje të veçantë kategorive më të cënueshme të fëmijëve siç janë fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët me nevoja të veçanta, viktimat e dhunës në familje, nxënësit, fëmijët që punojnë në rrugë, jetimët, fëmijët me mundësi të kufizuara. Partitë politike i përmendin disa herë këto nënkategorie të fëmijëve të cënueshëm dhe propozojnë qasje të ndryshme ndaj tyre. Në dritë të

⁶Numri total i përmendjeve të nënkategorive të grave.

kësaj, LVV-ja i përmend grupet e ndryshme të fëmijëve të cënueshmëm gjithsej gjashtë herë. Koalicioni PAN në programin e vet i përmend fëmijët njëzet herë, derisa koalicioni LAA i përmend fëmijët vetëm dy herë. Tabela 3 jep një pasqyrë të të gjitha përmendjeve të fëmijëve në programet e partive politike.

Tabela 3. Numri i përmendjeve të fëmijëve

#	Partia Politike/Koalicioni	Numri i përmendjeve
1	LDK, AKR and Alternativa (LAA)	2
2	Levizja Vetevendosjet! (LVV)	6
3	PDK, AAK, and Nisma (PAN)	20

Kategorira e katërt e mbuluar me këtë monitorim është ajo e personave me nevoja të veçanta. Dy nënkategoritë e përfshira brenda këtij grupi janë personat me nevoja të veçanta (nevoja fizike dhe mendore) si dhe fëmijët me sjellje asociale. Në dritë të kësaj, koalicioni LAA nuk e përmend specifikisht këtë kategori të personave, derisa LVV-ja e përmend atë vetëm një herë. Koalicioni PAN udhëheq në këtë kategori me gjithsej tri përmendje të personave me nevoja të veçanta.

Tabela 4. Numri i përmendjeve të personave me nevoja të veçanta

#	Partia Politike/Koalicioni	Numri i përmendjeve
1	LDK, AKR and Alternativa (LAA)	0
2	Levizja Vetevendosjet! (LVV)	1
3	PDK, AAK, and Nisma (PAN)	3

Kategoria e pestë e përfshirë në monitorim përfaqëson grupet më të pafavorshme financiare në shoqëri. Të varfërit, sipas kufizimit të organizatave ndërkombëtare, janë personat që jetojnë me më pak se 1 dollar në ditë. Brenda këtij monitorimi, ekipi ka veçuar/u ka kushtuar vëmendje të veçantë grupeve të marginalizuara dhe përfituesve të ndihmës sociale. Në dritë të kësaj, LVV-ja është e vetmja parti/koalicioni që nuk i përmend specifikisht të varfërit, përkundër faktit se veten e quan parti të qendrës së majtë. Koalicioni PAN i përmend të varfërit dhe varfërinë gjithsej dy herë, derisa koalicioni LAA këtë kategori e përmend gjithsej gjashtë herë në programin e vet. Tabela 5 jep një pasqyrë të të gjitha përmendjeve të të varfërve dhe të varfërisë në programet e partive politike.

Tabela 5. Numri i përmendjeve të të varfërve

#	Partia Politike/Koalicioni	Numri i përmendjeve
1	LDK, AKR and Alternativa (LAA)	6
2	Levizja Vetevendosje! (LVV)	0
3	PDK, AAK, and Nisma (PAN)	2

Kategoria e gjashtë e përfshirë në këtë analizë ishin të papunët. Derisa të gjithë politikanët dhe udhëheqësit institucionalë pajtohen se papunësia është një prej prioriteteve më të mëdha, kjo nuk pasqyrohet domosdo edhe në programet e tyre politike. Tri nënkategoritë/temat specifike në kuadër të papunësisë të cilat i ka mbuluar analiza ishin të rinjtë: ish-të punësuarit në ndërmarrje shoqërore dhe punësimi. LVV-ja si partia e vetme e pozicionuar si qendër e majtë e përmend më se paku temën e papunësisë dhe kategorinë e personave të papunë, me vetëm tri përmendje të tilla të identifikuara në programin e vet. Koalicioni LAA e përmend këtë kategori gjithsej nëntë herë. Kësaj liste i prin koalicioni PAN, i cili e përmend papunësinë/punësimin gjithsej njëzet e nëntë herë.

Tabela 6. Numri i përmendjeve të të papunëve

#	Partia Politike/Koalicioni	Numri i përmendjeve
1	LDK, AKR and Alternativa (LAA)	9
2	Levizja Vetevendosje! (LVV)	3
3	PDK, AAK, and Nisma (PAN)	29

2.1.2. Politikat dhe masat e propozuara për çështjet dhe kategoritë sociale

Përveç shpeshtësisë së përmendjes së çështjeve dhe të politikave sociale si dhe të zgjidhjes së problemeve të kategorive të cënueshme sociale, monitorimi dhe analiza gjithashtu janë marrë me përmbajtjen/natyrën e mbulueshmërisë së tyre, dhe zgjidhjet e problemeve të identifikuara përbrenda kategorive sociale më të përjashtuara dhe më të cënueshme. Numri i përmendjeve të cekura më lart do të elaborohen në aspektin cilësor në këtë pjesë, për të ilustruar masat konkrete të propozuara nga partitë politike/koalicionet në ofertat e tyre zgjedhore.

Analiza e përmbajtjes/diskursit të programeve të partive politike jep një pasqyrë interesante idesh, konceptesh dhe qasjesh të ofruara nga partitë politike si përgjigje ndaj sfidave të identifikuara përkritazi me

politikat sociale. Në dritë të kësaj, aspekti cilësor i monitorimit gjithashtu u fokusua në grupet dhe kategoritë specifike për të cilat janë prezentuar analizat e lartcekura. Grupet e synuara të mbuluara me këtë monitorim përfshinë: të moshuarit, gratë, fëmijët, personat me nevoja të veçanta, të varfërit, të papunët, dhe kategoritë sociale që kanë të bëjnë me luftën.

2.2. Programi zgjedhor 2017

2.2.1. Koalicioni

LDK-AKR-Alternativa (LAA)

Për sa u takon të moshuarve, disa prej nocioneve të cilat i ka mbuluar monitorimi dhe analiza janë: njerëzit në moshë, mbi moshën 65-vjeçare; pensionistët; të moshuarit; përvoja e punës. Këto nocione përdoren më së shpeshti për ta përshkruar kategorinë e qytetarëve të moshuar si dhe politikat që u përshtaten nevojave të tyre. Në dritë të kësaj, koalicioni LAA, i cili doli i fundit në rangimin cilësor të përmendjeve të kësaj kategorie, gjithashtu nuk u gjet të jetë i vëmendshëm ndaj kësaj audience të synuar sa i përket cilësisë së përgjigjes. Përmendja e vetme e të moshuarve nga koalicioni LAA ka të bëjë me riorganizimin e mbrojtjes sociale dhe të skemave pensionale. Nëse bëhet një analizë retrospektive, gjatë mandatit të

fundit qeverisës kur LDK-ja e drejtonte MPMS-në, reformat e propozuara ishin në fakt negative për të moshuarit, duke ia hequr pjesës më të madhe të tyre pensionin bazik (beneficonet e shtyllës së parë), duke e shndërruar atë në skemë për të moshuarit të bazuar në nevojë.

Kategoria e dytë e personave të përfshirë në analizë janë gratë dhe nocionet specifike të monitoruara përfshinë: nënat; vajzat; gratë; lehonja për gratë e punësuar; lehonja për gratë e papuna; nënat e vetme; dhuna në familje; dhe nënat e reja. Në dritë të kësaj, disa prej propozimeve për t'iu përgjigjur nevojave të grave përbrenda programit politik të LAA-së përfshinë ndërtimin e Qendrës për Nënë dhe Fëmijë; Skema Financuese për biznese, me kuota specifike për gratë dhe për grupet e marginalizuara; Kuota për gra me subvencione dhe grante për bujqësi; pushim lehonie prej 12 muajsh për gratë e punësuar dhe pagesë 12-mujore për gratë e papuna me 50% të pagës minimale; referenca tjetër e LAA-së ka të bëjë me viktima të dhunës në familje, ku kërkohet trajtimi i tyre adekuat përmes autoriteteve lokale dhe OSHC-ve të certifikuara/licencuara për këtë qëllim.

Për sa u takon fëmijëve, si një prej kategorive më të cënueshme, koalicioni LAA i përmend vetëm

shkurtimisht kategoritë e ndryshme të fëmijëve. Në dritë të kësaj, veprimi i vetëm specifik i identifikuar gjatë monitorimit është ai që ka të bëjë me fëmijët pa kujdes prindëror, për të cilët mbështetja financiare është masa e vetme e propozuar/vërejtur. Kategoria e katërt e përfshirë në analizën cilësore është ajo e personave me nevoja të veçanta. Koalicioni LAA në programin e vet nuk e përmend specifikisht këtë kategori të personave apo zgjidhje për adresimin e nevojave të tyre. Kategoria e pestë e përfshirë në këtë monitorim përfaqëson grupin më të pafavorshëm financiarisht – të varfërit. Në dritë të kësaj, koalicioni LAA këtë grup e përmend gjashtë herë në programin e vet. Sigurimi i mbrojtjes së qëndrueshme sociale është referenca/masa e parë e propozuar për t'iu përgjigjur nevojave të këtij grupi të synuar. Funksionalizimi i Qendrave për Punë Sociale përmes rritjes së stafit dhe të buxhetit, është një referencë/masë tjetër e propozuar nga koalicioni LAA për t'i adresuar nevojat dhe sfidat e të varfërve. Referenca tjetër e identifikuar shprehet në nivel të qëllimit, duke u formuluar si "zvogëlimi i vazhdueshëm i varfërisë". Kategoria e gjashtë e përfshirë në këtë analizë ishin të papunët. Derisa të gjithë politikanët dhe udhëheqësit institucionalë pajtohen se papunësia

është një prej prioriteteve më të mëdha, kjo nuk pasqyrohet domosdo edhe në programet e tyre politike. Koalicioni LAA e ka përmendur papunësinë dhe të papunët si kategorigjithsej nëntë herë. Përmendja e parë vjen si premtim/qëllim zgjedhor dhe formulohet si papunësia e zvogëluar në përqindje njëshifrore në katër deri në gjashtë vite. Koalicioni LAA gjithashtu e ka prezentuar planin e vet me një të punësuar për çdo familje, përmes të cilit synon ta zvogëlojë papunësinë (të paktën pjesërisht). LAA-ja gjithashtu u ka premtuar vëmendje të posaçme punëtorëve të prekur nga privatizimi i ish-ndërmarrjeve shoqërore. Një masë tjetër e propozuar nga koalicioni LAA është hartimi i politikave aktive sociale të cilat promovojnë ndërmarrësinë dhe vetëpunësimin me qëllim të zvogëlimin të varësisë nga skemat sociale.

Duke marrë parasysh se LDK-ja e ka drejtuar MPMS-në, përmbajtja 'mjaft e zbehtë' përkitazi me politikat sociale mund të interpretohet vetëm si mungesë e vëmendjes ndaj politikave sociale, dhe jo pasojë e mungesës së informacioneve për këtë sektor. Për më tepër, disa prej qëllimeve/referencave të parapara në ofertën e tyre programore shpesh janë në kundërtënie të ndërsjellë për sa i takon qasjes dhe janë

2.2.2. Lëvizja Vetëvendosje! (LVV)

kundërproduktive karshi qëllimeve të tyre të përmendura. Pretendimi se po përmirësohet gjendja e të moshuarve përmes reformimit të skemave pensionale është oksimaron, ngase në praktikë LDK-ja provoi ta hiqte njërin prej tri shtyllave të skemës pensionale. Përmes përfshirjes së kritereve të bazuara në nevoja për Skemën Pensionale Bazike⁷, LDK-ja provoi t'i hiqte beneficinet e një pjese të madhe të kosovarëve nga kjo skemë. Si e tillë, referenca programore për reformimin e sistemit pensional mund të kuptohet vetëm si përpjekje për t'ua hequr kosovarëve beneficinin e vetëm me të holla i cili i kushtohet mbrojtjes së tyre nga rreziku i moshës së shtyrë, duke i bërë edhe më të cënueshmëm. Duke marrë parasysh se shtylla e dytë e skemës pensionale — Trusti i Kursimeve Pensionale, menaxhohet në mënyrë të pavarur nga fondi i kursimeve, i cili investohet në tregje ndërkombëtare që nuk garantohej nga Qeveria, cënueshmëria e kosovarëve do të rritej dukshëm me reformimin e skemës bazike pensionale.

Lëvizja Vetëvendosje! është partia e vetme politike me orientim të proklamuar majtist dhe shpesh është cilësuar nga kundërshtarët e saj dhe nga analistët e mediave si komuniste. Kur bëhet fjalë për politikën sociale dhe adresimin e nevojave të grupeve të marginalizuara në shumë raste del më dobët se dy koalicionet e tjera të analizuar në këtë raport. Sa u përket të moshuarve, sipas përkufizimit ata konsiderohen persona të moshës mbi 65 vjeç, që sipas legjislacionit të Kosovës është moshë e pensionimit si për burrat ashtu edhe për gratë. Për të moshuarit LVV-ja ka dhënë vetëm një premtim/masë konkrete dhe ajo është se gjatë mandatit të saj të parë ajo do ta rriste pensionin bazik⁸ në 150 euro në muaj, ndërsa pensionin të lidhur me punë⁹ deri në 280 euro në muaj.

Kategoria e dytë e personave të përfshirë në analizë janë gratë. Një referencë specifike e LVV-së për gratë në ofertën e saj programore përfshin krijimin e fondit të banimit social ku do t'u jepej prioritet grave aplikuese. Për më tepër, LVV-ja deklaroi se me qëllim të zvogëlimit të barrës së grave dhe të të gjithë punëtorëve do ta shtynte përpara orarin prej pesë ditësh pune për të punësuarit në pozita jomenaxhuese. Mbase njëra prej masave më kuptimplota të propozuara nga LVV-

⁷Skema pensionalebazike është pensioni universal i moshës, i cili u jepet të gjithë kosovarëve pavareësisht historisë së tyre të punës, situatës financiare apo të ardhurave.

⁸Skema PensionaleBazike është universale dhe krejtësisht e financuar nga shteti, dhe bazohet në Ligjin për Pensione

⁹Pensionet që kanë të bëjnë me punë janë skemë e përkohshme me vendim të Qeverisë, dhe mund të hiqet në çdo moment përmes një mase të ngjashme (vendim i Qeverisë). Ajo u jepet personave të cilët kanë punuar ose kanë dhënë kontribut aktiv në sistemin e kaluar, numri i të cilëve zvogëlohet çdo vit.

ja për gratë është ndërtimi i 160 çerdheve të reja në bashkëpunim me komunitat. Kjo do ta adresonte njërin prej sfidave më të mëdha për punësimin e grave (kujdesi i fëmijës), si dhe do të krijonte shumë mundësi për punësimin e grave në këto çerdhe. Fëmijëve të nënave të vetme thuhej se do t'u jepej prioritet në programin e ri të çerdheve.

Sa i përket kategorisë së tretë – atë të fëmijëve, LVV-ja i përmend gjashtë herë grupet e ndryshme të fëmijëve të cënueshëm. Disa prej masave konkrete të propozuara nga LVV-ja sa u përket politikave që synojnë përmirësimin e gjendjes së fëmijëve më të cënueshëm përfshinë beneficione në vlerë 10 euro në muaj për çdo fëmijë deri në moshën 15 vjeç. Një masë tjetër e propozuar nga LVV-ja ka të bëjë me ushqim në shkollë, ku parashiheshin pa pagesë për të gjithë nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e pestë, gjithashtu me qëllim të zgjerimit të shërbimit të ushqimit për të gjithë nxënësit. Po ashtu duhet cekur se të trija këto masa janë universale në natyrën e mbulueshmërisë, dhe aplikohen horizontalisht të gjithë fëmijët pavarësisht statusit të tyre ekonomik a social. Derisa ndikimi i tyre i synuar do të jetë i dukshëm/matshëm vetëm në situata më të cënueshme financiare, ato nuk kanë për qëllim të adresojnë nevoja specifike të nëngrupeve specifike

brenda kategorisë së gjithëmbarshme të fëmijëve.

Kategoria e katërt e mbuluar me këtë monitorim është ajo e personave me nevoja të veçanta. Në dritë të kësaj, LVV-ja ka bërë një koment shumë të shkurtër për personat me nevoja të veçanta. Një situatë e ngjashme gjithashtu u pa për sa i takon kategorisë së pestë të personave të përfshirë në këtë kategori – të varfërit. LVV-ja është e vetmja parti/koalicion që nuk i përmend të varfërit në mënyrë specifike, përkundër faktit se veten e quan parti të qendrës së majtë dhe përkundër propozimit të politikave sociale drejtuar të varfërve (p.sh. masat e propozuara për fëmijët). Masa e vetme konkrete për ta zbutur gjendjen e popullsisë me të ardhura të vogla nga LVV-ja ka qenë reformimi i tatimit progresiv në të hyra dhe reformimi i sistemit të tatimit të korporatave.

Sa i përket papunësisë dhe të papunëve, LVV-ja megjithëse quhet parti e qendrës së majtë këtë temë e përmend më së paku krahasuar me koalicionet e tjera të kësaj analize. Masa e parë e propozuar nga LVV-ja është krijimi i Fondit Sovran të Republikës së Kosovës, themelimi i Agjencisë së Zhvillimit të Kosovës, si dhe themelimi i Bankës së Kosovës për Zhvillim. Derisa nuk jepen shumë hollësi për funksionimin dhe

financimin e këtyre institucioneve, ato ofrojnë kornizë të gjithëmbarshme zhvillimore të cilën e propozon LVV-ja për ta adresuar sfidën e papunësisë. Një masë tjetër e propozuar nga LVV-ja, e cila hyn më shumë në fushën e të drejtave politike sesa në atë të të drejtat ekonomike është zvogëlimi i moshës së votimit në 16 vjet. Duke marrë parasysh mbështetjen e madhe që LVV-ja e gëzon sidomos te të rinjtë, një premtim i tillë mund të shihet më shumë si përpjekje për ta rritur fuqinë politike sesa si masë me ndikim të drejtpërdrejtë te të rinjtë.

2.2.3. PDK-AAK-Nisma (PAN) Coalition

Përveç tri partive politike të dala nga lufta e fundit¹⁰, koalicioni PAN gjithashtu ka përfshirë edhe një numër partish të vogla, dhe si rrjedhojë ka dalur si koalicioni me më së shumti vota në zgjedhjet e parakohshme nacionale të cilat u mbajtën në qershor të vitit 2017. Koalicioni i gjerë, qëllimi parësor i të cilit ishte të dilte fitues i zgjedhjeve të fundit, bazohet në masë të madhe në interesa personale të udhëheqësisë së këtyre partive. Duke u parë si përpjekje e dëshpëruar e PDK-së për ta mbajtur pushtetin, koalicioni besohet t'i ketë dëmtuar në masë të madhe anëtarët

e vet. Duke u parë si kundërshtarë të dikurshëm dhe, në rastin e Nismës, si kundërshtarë të drejtpërdrejtë të PDK-së, votuesit e anëtarëve të koalicionit nuk iu përgjigjën mirë kësaj aleance, e cila doli me një fitore me avantazh të vogël në këto zgjedhje. Individualisht, të gjithë anëtarët e koalicionit kanë më pak deputetë se në legjislacionin paraprak.

Në aspektin programor, koalicioni PAN ishte i mjegullt dhe nuk jepte ofertë programore koherente. Vlen të theksohet se në shumicën e paraqitjeve dhe të debateve publike, koalicioni PAN përfaqësohej nga anëtarët e PDK-së¹¹. Megjithatë, në përpjekjen më të mirë për t'i kapur aspektet që kanë të bëjnë me kategoritë e analizuar në këtë raport, IKS-i ka arritur të identifikojë disa prej çështjeve të përmendura/adresuara gjatë paraqitjeve të tyre në fushatë.

Sa i përket aspektit të parë të analizuar – të moshuarve, koalicioni PAN më së shumti i ka përmendur kategoritë e personave të moshuar, me gjithsej nëntë referenca për këtë kategori. Ndër premtimet e dhëna, koalicioni PAN është zotuar për rritje të pensionit me 30%; njohjen e përvojës së punës nga vitet e '90-a; krijimin e kushteve ligjore për të punuar pas moshës ligjore të

¹⁰Partitë të cilat drejtohen nga ish-komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

¹¹Duke u bazuar në ligjet e aplikueshme në Kosovë, mediat i ftonin përfaqësuesit e koalicioneve (dhe jo të partive) që si rrjedhojë u la pak hapësirë partnerëve të koalicionit me PDK-në.

pensionimit; politika të reja për të moshuarit pa kujdes familjar; nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për pensione me shtetet e tjera ku kosovarët e kanë fituar të drejtën e tyre për pensione; si dhe përmirësime të të gjitha skemave pensionale, duke përfshirë: pensionin bazik, pensionin kontributdhënës (në relacion me punën), pensionet për personat me nevoja të veçanta, pensionet e "Trepçës", pensionet e ish-TMK-së, si dhe pensionet e FSK-së. Derisa këto zotime përbëjnë vëmendjen më të madhe të kushtuar nga ndonjë parti/koalicion, ato gjithashtu duket të mos kenë ndonjë buxhetim apo planifikim të duhur, dhe ndryshimet e propozuara nuk do të ishin të mundura me buxhetin aktual të Kosovës.

Kategoria e dytë e personave të përfshirë në analizë janë gratë. Në dritë të kësaj, PAN-i i ka përmendur disa herë kategoritë e ndryshme të grave, duke përfshirë krijimin e Fondit për Mbështetjen e të Rinjve dhe Grave, Fondit për Barazi Gjinore dhe ndarjen e 20 milionë eurove për hapjen e bizneseve për gratë, dhe zbatimin e programeve të ndryshme për ngritje të kapaciteteve të grave; veprime favorizuese në politika tatimore për: a) biznese të cilat punësojnë gra, dhe b) biznese të krijuara/të drejtuara nga gratë; dhe njohja e profesionit të dados me

certifikimin e 300 grave për këtë profesion brenda periudhës katërvjeçare. Premtimet e tjera zgjedhore të bëra nga koalicioni PAN përfshinë zvogëlimin e kostove të pushimit të lehonisë për biznese për 50% përmes subvencionimit të stafit të përkohshëm zëvendësues. Koalicioni PAN gjithashtu është zotuar të shqyrtojë politika të reja për fuqizimin dhe mbështetjen e mëtutjeshme për strehimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Sa i përket kategorisë së tretë të monitoruar – fëmijëve, koalicioni PAN në ofertën e vet programore këtë kategori e ka përmendur njëzet herë. Ndër premtimet kryesore që kanë të bëjnë me fëmijët ishte themelimi dhe funksionalizimi i Programit të Fëmijërisë së Hershme; ndërtimi i 300 çerdheve dhe arritja e synimit të një çerdheje për 1000 banorë; mbështetja për fëmijët e diasporës; Programi për Mbrojtjen e të Miturve dhe rritja e inspektimit në fushën e punës së fëmijëve pa kujdes prindëror.

Kategorira e katërt e mbuluar me këtë monitorim është ajo e personave me nevoja të veçanta. Ngjashëm me kategoritë e tjera, koalicioni PAN gjendet në krye të listës sa i përket numrit të përmendjeve të kësaj kategorie, me gjithsej tri referenca

për personat me nevoja të veçanta. Si shembulli më i spikatur, koalicioni PAN ka propozuar kujdes të shtuar rezidencial për personat me probleme mendore në Institutin Special në Shtime, si dhe përmirësim të skemës së mbështetjes së familjeve me fëmijët e moshës 1-18 vjeç me nevoja permanente.

Për sa i takon kategorisë së pestë – personat me sfida financiare, koalicioni PAN i ka përmendur të varfërit dhe varfërinë gjithsej dy herë. Referenca e parë kishte të bënte me zvogëlimin e migrimit nga zonat rurale si dhe zbutjen e varfërisë përmes krijimit të vendeve të punës nga mbështetja për diversifikimin e aktivitetit bujqësor. Referenca e dytë që kishte të bënte me më të varfërit e shoqërisë ishte premtimi për t'i rritur beneficionet e Ndihmës Sociale për përfituesit e saj.

Kategoria e gjashtë e përfshirë në këtë analizë ishin të papunët. Kësaj teme i prin koalicioni PAN, i cili ka përmendur papunësinë/të papunët gjithsej njëzet e nëntë herë. Subvencionet për programe të praktikës në vlerë 50 euro përmes të cilave 5,000 studentë do të përfitonin përvojë pune praktike, ishte ndër zotimet zgjedhore të koalicionit PAN. Zgjidhjet e tjera të propozuara nga koalicioni PAN për zbutjen e papunësisë janë: krijimi i

60,000 vendeve të reja të punës përmes një Plani Veprimi konkret dhe zbatimi i 40 projekteve të investimit; Krijimi i Shërbimit Vullnetar Kombëtar ku vullnetarizmi do të njihej ligjërisht si përvojë pune dhe shërbimi publik do të paguhej nga Qeveria me pagë minimale; Fondi i Kapitalit për ndërmarrjet e mesme dhe të ulëta në pronësi të të rinjve; Kartela Rinore për personat nën moshën 26-vjeçare që i liron të rinjtë nga pagesat e shërbimeve publike; krijimi i vendeve të punës në sektorin e TIK-ut me lirime nga tatimi për punësime; Ndërtimi i Rafinerisë së Naftës përmes Partneritetit Publiko-Privat në Prizren dhe tërheqja e 400 milionë eurove investime dhe krijimi i më se 1,000 vendeve të punës; trefishimi i numrit të vendeve të punës në sektorin e xehtarisë brenda katër vitesh me më se 40,000 të punësuar;

Analiza aritmetike dhe përmbajtësore e premtimeve zgjedhore të tri partive/koalicioneve më të mëdha në zgjedhjet nacionale të vitit 2017 flet për një prioritet relativisht të vogël që partitë politike u japin kategorive më të cënueshme sociale. Ajo gjithashtu tregon për mungesën e një plani funksional dhe të jetësueshëm për t'u marrë me çështjet që i prekin kategoritë më të cënueshme. Në përgjithësi, analiza tregon se nuk mund të pritët shumë përmirësim nga partitë politike ekzistuese për t'u përgjigjur në mënyrë më efektive nevojave të kategorive më të pafat, si dhe për të ndërtuar një rrjetë sigurie dhe mbështetjeje rreth tyre. Zotimet politike të të gjitha partive politike/koalicioneve të monitoruara gjatë programit zgjedhor në të shumtën e rasteve nuk janë të konceptualizuara mirë, ofrojnë shumë pak inovacion, dhe/ose nuk janë të zbatueshme në Kosovë.

Koalicioni LAA i cili përfaqëson ndër pozicionet më konservatore dhe më neoliberalë, nuk i përfaqëson qoftë në aspektin e kohës, qoftë në aspektin e vëmendjes apo në aspektin e cilësisë së zgjidhjeve të ofruara kategoritë më të cënueshme në shoqëri. Përvoja e kaluar flet për gatishmërinë e kësaj partie ta zvogëlojë mbulueshmërinë e rreziqeve sociale (p.sh. nisma për

reformimin e sistemit pensional¹²) dhe programi zgjedhor ka dëshmuar pak apo nuk ka dëshmuar fare përmirësime krahas përvojës së kaluar. Meqë LDK-ja ka udhëhëqur sistemin e mirëqenies sociale në koalicionin e kaluar qeverisë, dhe e njëj mirë situatën, shpërfillja e çështjeve sociale në programin e saj mund të konsiderohet vetëm si mungesë ndjeshmërie ndaj këtyre çështjeve. Qasja konservatore ndaj skemave sociale pritët nga LDK-ja në të ardhmen në rast se i qëndron besnike diskursit aktual.

Koalicioni PAN (dha anëtarët e tij) kanë qenë pjesë e shumicës së qeverive që nga themelimi i institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse në kuadër të UNMIK-ut. PDK-ja si parti kryesore e këtij koalicioni ka qenë pjesë e secilës qeveri që nga shpallja e pavarësisë më 2008. Gjendja e tanishme dhe sistemi i dobët i mbrojtjes sociale mund t'i atribuohet në masë të madhe qeverisë së PDK-së dhe/ose mungesës së plotë të interesimit për kategoritë sociale në shoqërinë tonë. MPMS-ja asnjëherë nuk është drejtuar nga PDK-ja në cilindo prej koalicioneve qeverisëse në të cilat kjo parti ka marrë pjesë. Ajo gjithmonë ua ka rezervuar këtë ministri partnerëve të koalicionit nga radhët e komunitetit serb. Premtimet zgjedhore të paraqitura nga

¹²Koncept-dokumenti për Reformën Pensionale i inicuar nga LDK-ja: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Koncept-dokumenti_per_rregullimin_e_fushes_se_pensioneve_MPMS.pdf

Koalicioni PAN nuk mund të merren seriozisht nëse merret për bazë performanca e tyre në të kaluarën. Kalimi nga pakënaqësia totale në gjendjen e cila projektohet përmes premtimeve të tyre zgjedhore ka gjasa të vogla të ndodhë. Për më tepër, llogaritjet e thjeshta aritmetike të premtimeve zgjedhore flasim për naivitetin e disa prej propozimeve të dhëna nga koalicioni PAN.

LVV-ja në anën tjetër, e cila shpeshherë përshkruhet si partia më majtiste në sistemin e Kosovës, gjithashtu nuk ia del të ofrojë zgjidhje të jetësueshme dhe të bazuara në nevoja për kategoritë e cënueshme të shoqërisë. Ajo gjithashtu është peng i premtimeve populiste të cilat shpeshherë nuk mund të mbështeten nga buxheti aktual i Kosovës. Shumica e masave të propozuara nga LVV-ja janë sisteme në natyrë, dhe kështu kanë shumë implikime buxhetore. Premtime për rritje pagash, dhe plane për ndërtimin e qindra çerdheve janë ndër premtimet e tilla të cilat nuk bazohen në potencialin real të buxhetit të Kosovës. Beneficionet për fëmijë në vlerë 10 euro në muaj për secilin fëmijë nën moshën 15-vjeçare, do ta ngarkonin edhe më shumë buxhetin me rreth 2 milionë euro në muaj¹³. Ngjashëm me këtë, fondi i banimit, fondi i investimeve, si dhe intervenimet e

financuara nga shteti të propozuara nga kjo parti janë të pamundura nëse merren parasysh kufizimet buxhetore të Qeverisë së Kosovës. Për më tepër, LVV-ja nuk arrin t'i përfshijë nënsegmentet brenda popullsisë së cënueshme, dhe kështu nuk ia del t'i adresojë në mënyrë efektive nevojat e tyre. Në vend të propozimit të zgjidhjeve konkrete për shqetësimet specifike të secilës prej kategorive të cënueshme, LVV-ja prezenton reformën e përgjithshme sistimore për të cilat, në rastin më të mirë, do të duheshin dekada për të pasur efekt real, në rast se kjo në rend të parë do të ishte e mundur/e jetësueshme. Për shembull, në vend të propozimit të ndërtimit të 160 çerdheve (për ndërtimin e të cilave do të nevojiteshin dhjetëra milionë euro si dhe dhjetëra milionë euro të tjera në vit për t'i menaxhuar/mirëmbajtur ato), shërbimet e çerdheve do të mund të ofroheshin në bashkëpunim me sektorin privat përmes modeleve të duhura publiko-private. Një qasje e tillë do të siguronte shërbime të çerdheve menjëherë, dhe njëkohësisht do ta zvogëlonte presionin ndaj investimeve kapitale dhe buxhetit. Një shembull tjetër i një qasjeje të tillë është propozimi i kësaj partie për shujta falas në shkolla publike, që ka pak gjasa t'i zgjidhë çështjet e ushqyeshmërisë së të varfërve, meqë cilësia e ushqimeve të

¹³Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rreth 200 mijë fëmijë konsiderohet të jenë nën moshën 15-vjeçare.

tilla me kufizimet buxhetore të Kosovës do të ishte mjaft e ulët. Përvoja në Komunën e Prishtinës, ku shujtat tashmë ofrohen nëpër shkolla, është dëshmi se si kufizimet buxhetore ndikojnë në cilësinë e ushqimeve të ofruara.

Sjellje e Kuvendit të zgjedhur rishtazi gjithashtu mund të jetë dëshmi se gjërat ka gjasa të mbesin të pandryshueshme për kategoritë e cënueshme sociale. Legjislacioni aktual në njërin prej votimeve të para e ka hedhur poshtë ligjin/amendamentin i cili do t'u mundësonte 6,195 fëmijëve me nevoja të veçanta qasje në arsim. Rritja e paraparë e buxhetit prej 739 mijë eurove ishte paraparë për t'i paguar rreth 100 psikologë/pedagogë, ose rreth 50 ndihmësmësues në shkolla fillore¹⁴. Në të njëjtën kohë, koalicioni qeverisës (i cili e ka shumicën e thjeshtë me 61 vota në Kuvend) e ka miratuar vendimin e Qeverisë për t'i dyfishuar pagat e zyrtarëve të kabinetit. Ky vendim u konsiderua i jashtëligjshëm nga Agjencia Kundër Korrupsionit si dhe shkelje e Ligjit kundër Konfliktit të Interesit.

Mediat dhe shoqëria civile gjithashtu kanë qenë mjaft pasive sa u përket politikave sociale dhe mirëqenies së grupeve më të cënueshme. Hiq një numër organizatash me anëtarësim

të cilat përfaqësojnë grupet/segmentet e cënueshme, vetëm disa OSHC u kanë kushtuar vëmendje këtyre kategorive. Koalicioni për Drejtësi Sociale i themeluar rishtazi është partneriteti i vetëm ndërsektorial që synon drejtësi më të madhe sociale, i cili ka arritur ta grumbullojë një masë të madhe organizatash të cilat së bashku u japin kontribut këtyre çështjeve. Mediat, sikurse OSHC-të, kryesisht janë peng i përcimit të informacioneve protokollare dhe nuk arrijnë t'i vokalizojnë nevojat dhe prioritetet e atyre më në nevojë dhe më të pafat. Në vend të kërkimit të drejtësisë më të madhe sociale, mediat u shkojnë pas partive politike dhe në të shumtën e kohës futen në gracka të politikës së lartë, duke u lënë pak hapësirë telasheve ditore dhe më nevojtarëve.

¹⁴Raporti i mediave për votën e Kuvendit mund të shihet këtu: <http://ëëë.koha.net/arberi/65692/deputetet-refuzuan-te-perkrahin-6-mije-e-195-femije-me-nevoja-te-vecanta/>

BIBLIOGRAFIA

- ASK (2016), Anketa e Fuqisë Punëtore 2016, Prishtinë 2017
- ASK (2016), Statistikat e Arsimit 2016, Prishtinë 2017
- ASK (2016), Statistikat Sociale 2016, Prishtinë 2017
- ASK (2017), Vjetar Statistikor 2016, Prishtinë 2017
- Baftiu, B (2017), Intervistë personale, 2017
- Baldëin, J (1990), Ëelfaare Redistribution and Solidarity, Oxford University Press 1990
- Bartlett, E. and Xhumari, M. 2008. Social Security Policy and Pension Reforms in the Eastern Balkans, European Journal of Social Security, 2008, 9 (4) : 297-322
- Berisha, A (2017), Intervistë personale, 2017
- Brovina, F (2017), Intervistë personale, 2017
- Bytyqi, Sh (2017), Intervistë personale
- Cocozzelli, F (2011), Ëar and Social Ëelfare Routledge, 2011
- Espig-Andersen, G., (1996), 'After the Golden Age? Ëelfare State Dilemma in a Global Economy" and "Positive-Sum Solutions in a World of Trade-offs?' in Esping-Andersen, ed. Ëelfare States in Transition, SAGE Publications.
- Fultz E. (2004), 'Pension reform in the EU accession countries: Challenges, achievements and pitfalls', International Social Security Review, vol. 57, 2/2004
- Gaxherri, B (2017), Intervistë personale, 2017
- GazetaExpress (2015), Rriten pensionet për 100 euro, <http://ëëë.gazetaexpress.com/lajme/riten-pensionet-per-100-euro-137905/?archive=1>
- Gubbels, J. et al, 2007. The Kosovo Pension Reforms: Achievements and Lessons, SP Discussion Paper, The World Bank, No 0707, Washington, DC
- Hasani, N (2017), Intervistë personale, 2017
- Hausermann, L (2010), Ëelfare Modernisation in Hard Times, Oxford University Press, 2010
- IMF (2010), Pension Reforms in Emerging Europe: The Uncertain Road Ahead, Washington DC, 2010

IMF. 2011, Republic of Kosovo: Staff Report for First Assessment Under the Staff Monitoring Program, Country Report 11/374, December 2011

International Labour Organization (2010), Profile of the social security system in Kosovo, ILO Sub-regional office in Budapest

Iversen, A & Cusack, S (2010), Causes of Welfare State Expansion, SAGE Journal Vol 4, 2010

Kadriaja, T (2017), Intervistë personale, 2017

Koha Ditore (2017), Plani i Kryeministrit, Nr. 7151, 4 qershor 2017, Prishtinë

KosovaPress (2017), Hoti: Do t'i rrisim pensionet bazike 40 përqind, <http://ëëë.kosovapress.com/sq/zgjedhjet-2017/hoti-do-t-i-rrisim-pensionet-bazike-40-perqind-117609/>

Kosovo Tëo Point Zero (2015), Të ngecur në banim social, <http://kosvotëopointzero.com/stuck-in-social-housing-kosovos-ëëëak-policies-and-lack-of-commitment/>

Ligji Nr. 03/212 i Punës në Republikën e Kosovës, 2010

Ligji Nr. 03/L – 100 për Pensionet e Pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, 2011

Ligji Nr. 03/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, 2011

Ligji Nr. 03L/017 për Inspektoratin e Punës, 2011

Ligji Nr. 03L/164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, 2010

Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2014

Ligji Nr. 04/L-172 për Statusin e Dëshmorëve, Veteranëve dhe Invalidëve në Republikën e Kosovës, 2014

Ligji Nr. 04L-249 për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Kosovës, 2014

Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, 2017

Ligji Nr. 4/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës

LDK (2012), Programi Politik, Prishtinë

LDK (2017), Kontakti me Kosovën, Prishtinë

- MPMS (2016), Raporti Vjetor 2015, Prishtinë
- Musmurati, B (2017), Intervistë personale, 2017
- Palier, M (2009), The Sequential Transformation of Bismarkian Welfare State, Routledge, 2009
- Paqaku, K (2017), Intervistë personale, 2017
- PKD (2014), Misioni i Ri, Prishtinë
- PKD/AAK/NISMA (2017), Koha për Fillimin e Ri, Prishtinë
- Pierson, P (1996). The new politics of the welfare state. World public, Volume 48 No. 2, pp. 143-179
- Quni, A (2017), Intervistë personale, 2017
- N.N (2017), Intervistë personale, 2017
- Topalli, F. (2017), Intervistë personale, 2017
- Tsebelis, G (1992), Veto Players: How Political Institutions Work?, Princeton: Princeton University Press
- Rregullorja e UNMIK–ut Nr. 2001/35 për Sistemin Pensional në Kosovë
- Vetëvendosje (2013), Alternativa Qeverisëse, Prishtinë
- Vetëvendosje (2017), Plani me 100 Pika, Prishtinë
- World Bank (2007), Pension Reform and the Development of Pension System: An Evaluation of World Bank Assistance
- World Bank (2008), Kosovo – Technical Background Paper Social Sectors: Policy issues in the social sectors
- World Bank, 2008. Kosovo: Policy Issues in the Social Sectors, Washington, DC
- World Bank, 2016. Averting human crises during the global downturn: policy options from World Bank's Human Development Network. Washington, DC.
- World Bank. 1994. Averting the old-age crisis. Policies to protect the old and promote growth. Oxford University Press, Washington, DC
- Xhumari, M (2010), "Challenges facing the old-age pension system in the Eastern Balkans", ISSA Conference "Emerging trends in time of instability: New challenges and opportunities for social security", 29 September – 1 October 2010 Luxembourg

SHTOJCA 1. Indeksi i shprehjeve të politikave sociale të përdorura nga partitë politike

Përfshirja e Çështjeve Sociale në Programet e Partive Politike


Në terma të përgjithshëm, programet e partive politike në Kosovë janë të gjëra, por që nuk përmbajnë zgjidhje konkrete të problemeve për të cilat edhe bëhen. Edhe në ato raste kur kanë paraqitur ndonjë propozim, janë të ekzagjeruara dhe është dëshmuar se janë bërë vetëm për fushatë elektorale.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS, në kuadër të hulumtimit “Përfshirja sociale në programet e partive politike”, ka bërë një analizë të programeve me të cilat partitë politike kanë garuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017. Pas tjerash janë evidentuar shprehjet e përdorura që përshkruajnë kategoritë dhe çështjet sociale.

Bazuar në dhënat e paraqitura në mënyrë tabelore, vërejmë se kategoritë e të moshuarve, grave, fëmijëve, personave me nevoja të veçanta, të varfëritë, të pa punët dhe kategoritë e luftës, del se ka prej atyre partive që nuk i përmendin fare. Kurse kategori më specifike, siç janë nënat vet-ushqyese apo edhe nënat kryefamiljare, nuk gjenden askund në programet e partive politike. Në të njëjtën mënyrë, pothuajse në të gjitha partitë politike nuk parashihet ndihma për lehonat e pa punësuar.

Një tjetër element i rëndësishëm, që evidentohet në këto grafe, është mos përmendja asnjëherë e kategorisë së të moshuarve nga partitë politike të cilat janë të deklaruara si të majta dhe socialdemokrate.

Në të kundërt të kësaj, kategoria e fëmijëve dhe punësimi janë paraqitur më së shumti. Pjesa më e madhe e programeve të partive politike përmban përshkrim të situatës, kur ato janë hartuar. Në një masë minimale partitë provojnë t'i përmbahen profilit të tyre ideologjik, por mënyra e të vlerësuarit të gjërave i bën ato sa të majta edhe të djathta, sa liberale aq edhe konservatore.



Nr.	KATEGORITE	SHPREHJE TË TJERA	VITI	PARTITË POLITIKE		
				VETËVENDOSJA	PAN PDK/AAK/NISMA	LAA LDK/AKR/ALT
1	POLITIKE	1. Pleq 2. Mbi 65 vjet 3. Pensionistët 4. Të moshuarit 5. Stazhi	2017	3	7	1
				1. Deri në fund të mandatit pensioni bazë do të rritet në €150, ai kontributdhënës €280.	1. Rritja e pensioneve për 30% 2. Pranimi i stazhit të viteve të 90-ta. 3. Krijimi i kushteve për të punuar përtej moshës legale të pensionit; 4. Krijimi i politikave të reja për të moshuarit pa përkujdesje familjare 5. Nënshkrimi i marrëveshjeve në sferën e pensioneve me vendet ku kanë punuar shtetasit e Kosovës.	1. Riorganizim i skemës së mbrojtjes sociale dhe pensionale.
				1	0	1
					1. Ndërtimi i Qendrës për Nenen dhe Fëmijën	
	GRATË	1. Nënëat		0	0	1
		2. Femrat				1. Krijimi i skemave financuese për bizneset, me kuota specifike për femrat dhe grupet e marginalizuara.
		3. Gratë		4	9	3
				1. Krijimi i Fondit për përkrahjen e Rinisë dhe Gruas. 2. Themelimi i fondit për Barazi Gjinore dhe ndarja e €20M për: garancinë për kreditës; përkrahje e ideve për Start-ups nga Gratë, si dhe zbatimi i programeve të ndryshme të kualifikimit për gra. 3. Krijimi i politikave të veçanta për të siguruar lehtësira tatimore për a) bizneset private që punesojnë gra dhe b) bizneset që themelohen e udhëhiqen nga gratë. 4. Njohjen e dadove si profesion me ligj - Certifikimi i 300 dadove për 4 vjet.	1. Krijimi i fondit banesor për banim të përbalueshem dhe banim social, ku përparësi të lartë do të kenë gratë aplikante. 2. Për të mos i rënduar gratë dhe çdo punëtorë, nuk do të lejojme punën mbi pesë ditë në javë për punëtorët në pozita jomenaxheriale.	1. Në bujqësi, gratë do të kenë kuota të veçanta për subvencione dhe grante.

			0	7	2
	4. Lehonat			1. Uljen e kostos së pushimit të lehonisë për punëdhënësit në dy mënyra: subvencionim i zëvendësuesit gjatë pushimit të lehonisë si dhe ulje e kostos së lehonisë nga ana e punëdhënësit në këtë format: rregullimi i pushimeve të lehonisë.	1. Gratë lehona të cilat janë të punësuar, do të marrin 12 muaj pushim të lindjes, me pagesë. 2. Lehonat të cilat nuk janë të punësuar, do të marrin 50% të pages minimale për 12 muaj.
	5. Dhuna në familje		0	1	1
				1. Do të shqyrtohen politika të reja që fuqizojnë përkrahjen shtetërore në strehimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.	1. Trajtim adekuat të viktimave të dhunës, përmes qeverive lokale dhe organizatave jo-qeveritare të certifikuar për këtë qëllim.
	6. Nënata Vetë ushqyese		1	0	0
		Hapja e 160 çerdheve të reja në bashkëpunim me komunat – Një prioritet të veçantë në këtë program do të kenë fëmijët e nënave vetushqyese.			
FËMIJËT	1. Pa përkujdesje 2. Fëmijët me nevoja të veçanta 3. Viktima të dhunës 4. Nxënësit 5. Arsimit 6. Jetimet		6	20	2
		1. Shtesa nga 10 Euro nëmuaj për fëmijët nën moshën 15 vjeçare. Shtesa do të paguhet në emër të nënës. 2. Ushqim falas për fëmijët e klasave fillore nga 1 deri në 5 3. Planifikimi dhe zbatimi për shërbimin e ushqimit për të gjithë nxënësit.	1. Ndërtimi dhe funksionalizimi i Programit për Fëmijërinë e Hershme. 2. 300 çerdhe, çdo 1000 banorë, një çerdhe. 3. Përkrahja për fëmijët e diasporës. 4. "Programi i përkujdesjes për të miturit" dhe kontrolli në vend që të mos ketë fëmijë që punojnë dhe që janë braktisur. 5. "Subvencionim i pagës së internship". Në kuadër të këtij programi 5.000 studente do të përkrahen me nga 50 euro.	1. Mbështetje financiare për fëmijët pa përkujdesje prindërore.	
	1. Personat me aftësi të kufizuara 2. Fëmijët me sjellje asociale		0	3	0
				1. Rritja e përkujdesjes institucionale 24 orëshe për personat me aftësi të kufizuara mendore në Institutin Special në Shtime. 2. Do të avancohet skema për mbështetje të familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme prej 1-18 vjet.	
TË VARFËRIT	1. Rastet sociale 2. Të magjinalizuarit		1	2	6
		1. Reformimi progresiv i tatimit në të hyra, si dhe reformimi i tatimit për Korporatat.	1. Reduktimi i migrimit dhe ulja e varfërisë në zonat rurale, do të krijohen mundësi për vende të reja pune në ato zona, duke e përkrahur diversifikimin e aktivitetëve bujqësore. 2. Do të rritet ndihma sociale për familjet në nevojë të përfshirjes në Skemën e Ndihmës Sociale.	1. Funksionalizimin e Qendrave për Punë Sociale përmes rritjes së stafit dhe buxhetit.	

2

TË PAPUNËT

1. Punësimi
2. Ish – punëtorët e ndërmarrjeve publike dhe shoqërore
3. Të rinjtë

3

KATEGORITË E LUFTËS

1. Invalidët e luftës
2. Veteranët e Luftës
3. Familjet e dëshmorëve

3	29	9
<p>1. Krijimi i Fondit Sovran të Republikës së Kosovës. Agjencisë Zhvillimore të Kosovës dhe Bankës Zhvillimore të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Të rinjve dhe të rejave nga moshë 16 vjeçare do t'u jepet e drejta e votimit.</p>	<p>1. Subvencionim i pagës së internshipit – 5K studentë nga €50.</p> <p>2. Krijimi i 60K vendeve të reja të punës përmes Planit Operativ për nxitjen dhe zbatimin e 40 projekteve investive.</p> <p>3. Ndërtimi i 'Shërbimit Shtetëror të Vullnetarizmit.</p> <p>4. Fondi për igrancimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga të rinjtë [Equity Fund].</p> <p>5. Karta e Rinisë deri në moshën 26 vjeçare – lirim në shërbime publike.</p> <p>6. Nxitje e të punësuarve në sektorin e ICT-se nëpërmjet lehtësirave tatimore.</p> <p>7. Ndërtimi i një Rajnerie Naftë në Prizren duke e nxitur nëpërmjet Partneriteteve Publiko-Private një investim prej € 400M në ndërtim in e saj dhe hapjen e 1K vendeve të reja të punës.</p> <p>8. Trejshimi i të punësuarve në sektori e minierave për katër vite, rreth 40K të punësuar.</p> <p>9. Ndërtimi i 'Shërbimit Shtetëror të Vullnetarizmit' ku vullnetarizmi do të njihet si përvojë pune. Kjo mbështetet me rrogë minimale në shërbime publike dhe angazhimi njihet si përvojë pune.</p>	<p>1. Norma e papunësisë në numër një shifror brenda 4-6 viteve.</p> <p>2. Një të punësuar, së paku për çdo familje.</p> <p>3. Kujdes i veçantë për punëtorët që preken nga privatizimi.</p> <p>4. Zhvillimi i politikave aktive sociale që promovojnë ndërmarrësin dhe punësimin për ta zvogëluar varësinë nga skemat sociale.</p>
2	5	0
<p>1. Do të ndryshohet I ligji për veteranët e luftës çlirimtare</p>	<p>1. Në bashkëpunim me shoqatat e kategorive të dala nga lufta do të bëhet identifikimi i menyrave të tjera, alternative, të rritjes së përkrahjes për veteranët dhe invalidët e luftës, krahas pensioneve që gëzojnë sipas legjisllacionit në fuqi.</p>	


Politikat Sociale

www.iksweb.org

**në Programet e Partive Politike:
A ka rëndësi barazia?**

The views expressed in this publication are not necessarily those of the Friedrich Ebert Foundation or of the organizations for which the authors work.

The publication is available online at www.fes-prishtina.org



Politikat Sociale

në Programet e Partive Politike:

A ka rëndësi barazia?